

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria DEVELALB CONSTRUCTION SHPK ("Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër identifikimi NUIS L91608011D.

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Durrësit, Nr. 111, Tirane.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kryerja e veprimtarive në fushën e ndertimit, si dhe veprimtari tregtare për shitblerje të materialeve të ndertimit, etj.

Në aktivitetin e saj shoqëria përfaqësohet nga Administratorët, Z. Kujtim Shtufi dhe Z. Enea Kaçi, të cilët ushtrojnë detyrën veç e veç ose së bashku, në përputhje me politikat e përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve, pa kufizime të kompetencave.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të lejuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK).

Përgatitja dhe hartimi është kryer në bazë të regjistrimeve kontabel të mbajtura për qëllime të raportimit konform Ligjit "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike dhe sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri, deklaratimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

2.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e SKK të përmirësuara, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rëndësishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbizbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet.

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

2.6 Periudhat krahasuese

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël ne vijim janë aplikuar ne mënyre te qëndrueshme ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare, me përjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka te tilla.

3.1 Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlerësohen ne fund te çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar te këmbimit ne datën e raportimit.

Mjetet jo-monetare ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit te datës se kryerjes se transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare qe maten me vlere te drejte rivlerësohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën kur përcaktohet vlere e drejte.

Fitimi ose humbja qe rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit te përdorura për konvertim ne 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Lek /EUR	114.25	120.76
Lek /USD	107.05	106.54

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përbehen nga llogari te arkëtueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhëna dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, përveç siç përshkruhet me poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlere te drejte nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet me poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë te drejtat kontraktuale te shoqërisë mbi flukset e parasë se aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne datën e transaksionit, qe është data ne te cilën shoqëria angazhohet te blejë apo te shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale te shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogarite rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri ne tre muaj.

Llogarite e arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera te arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve te arkëtueshme llogaritet kur ka te dhëna se shoqëria nuk do te jete ne gjendje te mbledhë te gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare te debitorit, mundësia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arkëtueshme te zhvlerësohen.

Shuma e provigjionit llogaritet si diference midis vlerës se mbetur dhe vlerës aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parasë te skontuara me normën efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre te drejte dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (Vazhdim)

3.2 Instrumentet financiare (Vazhdim)

Huamarrjet dhe parapagimet

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metode për llogaritjen e koston se amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhe me të shkurtër.

Te tjera

Huatë afatgjata të klasifikuara si transaksione financiare janë matur dhe paraqitur me vlerën aktuale të pagesave të ardhme, të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

3.3 Aktivet afatgjate materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës drejkt dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjate material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si zëra të ndryshëm të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjate materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjate material mbetur dhe njihen në të ardhura ose humbje të tjera.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjate materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen. Metodatat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të mëparshme janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%	(mbi vlerën e mbetur)
Makineri dhe pajisje	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Mjete transporti	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje kompjuterike	25%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje zyre dhe të tjera	20%	(mbi vlerën e mbetur)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (Vazhdim)

3.4 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes fillestare inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen. sipas metodës së koston mesatare te ponderuar.

3.5 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe të cilat mund të maten me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parashtuara të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare te shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit të saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjësve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

3.7 Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë së bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Të ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (Vazhdim)

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

3.11 Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

4 MJETET MONETARE

Gjendja e mjeteve monetare në datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si vijon.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Mjete monetare në bankë		
- në Lekë	2,457,168	131,551
- në monedhë të huaj	4,161,010	186,862
Mjete monetare në arkë	7,259,033	2,124,477
Totali	<u>13,877,211</u>	<u>2,442,889</u>

5 TË DREJTA TË ARKETUESHME

Gjendja e kërkesave për arkëtim në datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si vijon.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Kliente	279,841,154	44,199,936
TVSH e zbriteshme	10,332,368	4,421,274
Parapagime të tjera	26,498	-
Hua për administratorët	5,935,791	-
Totali	<u>296,135,811</u>	<u>48,621,210</u>

6 INVENTARËT

Në këtë zë janë përfshirë materialet dhe elementë të tjerë të inventarit, balanca e të cilave më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë::

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Materiale dhe mallra	58,461,860	30,792,906
AAGj të mbajtura për shitje	28,456,000	-
Parapagime për inventare	10,197,241	361,738
Totali	<u>97,124,101</u>	<u>31,154,643</u>

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

7 SHPENZIME TË SHTYRA

Në këtë zë janë përfshirë situacioni i investimit ndërtimor si dhe shpenzimet dhe pagesat e kryera për investimet ndërtimore, balanca e të cilave më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Situacioni i investimit në proces	395,587,602	108,158,230
Vlera e investimit e kaluar ne shpenzime	(121,000,000)	(61,000,000)
Shpenzime investimin në proces	63,709,752	58,709,752
Totali	<u>338,297,354</u>	<u>105,867,982</u>

8 AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE

Aktive afatgjata financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Huadhenie afatgjata për palë të lidhura	34,314,840	26,072,540
Totali	<u>34,314,840</u>	<u>26,072,540</u>

9 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Mjete Transporti	Instalime dhe Pajisje	Të tjera AAGj Materiale	Totali
Vlera Bruto				
Gjendje me 01.01.2021	3,620,998	468,116	-	4,089,114
Shtesa	-	-	-	-
Pakesime	3,620,998	-	-	3,620,998
Gjendje me 31.12.2021	-	468,116	-	468,116
Shtesa	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2022	-	468,116	-	468,116
Amortizimi i akumuluar				
Gjendje me 01.01.2021	736,897	88,628	-	825,525
Amortizimi i vitit	288,410	75,898	-	364,308
Pakesime	1,025,307	-	-	1,025,307
Gjendje me 31.12.2021	-	164,526	-	164,526
Amortizimi i vitit	-	60,718	-	60,718
Pakesime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2022	-	225,244	-	225,244
Vlera e mbetur neto				
Gjendja me 01.01.2021	2,884,101	379,488	-	3,263,589
Gjendja me 31.12.2021	-	303,590	-	303,590
Gjendja me 31.12.2022	-	242,872	-	242,872

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK**Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022****10 TË PAGUESHME PËR AKTIVITETIN E SHFRYTEZIMIT**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Furnitorë	363,448,262	97,364,141
Totali	<u>363,448,262</u>	<u>97,364,141</u>

11 TE PAGUESHME PËR DETYRIMET TATIMORE

Te pagueshme për detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen nga:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Tatimi mbi fitimin	1,872,463	1,919,986
Sigurime shoqerore dhe shendetsore dhe TAP	271,437	176,540
Tatimi ne burim	-	1,500
Totali	<u>2,143,900</u>	<u>2,098,026</u>

12 ARKËTIMET NË AVANCË PËR POROSI

Paraqiten arkëtimet në avancë për porosi në investimin ndërtimor mbi bazën e kontratave paraprake. Këto parapagime njihen në të ardhura në përputhje me progresin e punimeve.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Arkëtimet bruto në avancë për porosi nga klientët	523,066,764	125,937,093
Arkëtime të njohura në të ardhura	(169,500,000)	(80,000,000)
Totali	<u>353,566,764</u>	<u>45,937,093</u>

13 TË TJERA TË PAGUESHME AFATGJATA

Detyrimet te tjera përfaqëson financime nga administratorët dhe ortakët dhe më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Financime nga ortakët	-	33,464,059
Totali	<u>-</u>	<u>33,464,059</u>

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK
 Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

14 KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 10,000,000 Lekë. Struktura a ortakëve është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>		<u>31 dhjetor 2021</u>	
Illir Shtufi	50%	5,000,000	50%	5,000,000
Isuf Berberaj	30%	3,000,000	30%	3,000,000
Kujtim Shtufi	20%	2,000,000	20%	2,000,000
Totali	100%	10,000,000	100%	10,000,000

15 TË ARDHURA NGA VEPRIMTARITË

Të ardhurat nga aktiviteti për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Shitje punime ndërtimore (situacione)	172,482,957	35,026,289
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	172,482,957	35,026,289
Te ardhura të njohura nga investimet ndërtimore	89,500,000	80,000,000
Të ardhura nga parapagimet	89,500,000	80,000,000
Shitje të tjera materiale dhe mallra	123,224,399	1,916,134
Shitje Aktive afatgjata	-	2,732,865
Fitime nga efektet e kursit të monedhës	-	134
Të ardhura të tjera te shfrytëzimit	123,224,399	4,649,133
Totali	385,207,356	119,675,422

16 LËNDA E PARË DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si vijon:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Kosto e inventareve te shtur dhe perdorur ne ndertim	191,278,988	9,626,555
Sherbime te nenkontraktuara per ndertimin	87,658,742	16,685,771
Bl.energji,avull,uje	4,307,998	613,834
Shpenzime te tjera materiale	154,984	2,650
Totali	283,400,713	26,928,809

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

17 SHPENZIME TË LIDHURA ME INVESTIMET

Pjesa e situacionit dhe shpenzimeve të investimit e njohur në rezultat gjatë periudhës si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzimeve të investimit të njohura në rezultat	(60,000,000)	(61,000,000)
Totali	(60,000,000)	(61,000,000)

18 SHPENZIME TË PERSONELIT

Kosto e punës përbëhet nga pagat bruto të punonjësve dhe kostot e sigurimeve shoqërore që paguan shoqëria si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime për paga	8,783,536	6,116,647
Kontributet e sigurimeve	1,411,128	969,415
Totali	10,194,664	7,086,062

Numri mesatar i personave (përfshirë drejtimin) të punësuar gjatë periudhës ishte 30.

19 SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI

Shpenzimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Taksa dhe tarifa vendore	979,800	1,102,578
Shpenzime qiraje	140,001	260,000
Shërbime bankare	69,871	38,990
Gjoha dhe dëmshperblime	175,355	131,324
Shërbime personel i jashtëm	428,550	-
Shpenzime postare e telekomunikim	40,000	-
Shpenzime transporti	-	7,083
Vlera kontabel e AQ te shitura	-	2,595,691
Shërbime noteriale dhe juridike	-	15,200
Publicitet, reklama	-	26,583
Shpenzime të tjera	-	210,400
Totali	1,833,577	4,387,849

DEVELALB CONSTRUCTION SHPK

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

20 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Fitimi (humbja) para tatimit	29,717,684	19,908,393
Shpenzime te panjohura	175,355	131,324
Fitimi i tatueshem neto per vitin	29,893,039	20,039,717
Humbje te mbartura	-	-
Baza e llogaritjes së tatimit	29,893,039	20,039,717
Përqindja e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	4,483,956	3,005,957
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	2,611,493	1,085,971
Tat. fitimi per tu paguar / (mbartur) ne periudha te tjera	1,872,463	1,919,986

21 PALËT E LIDHURA

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Personat drejtues të shoqërisë konsiderohen palë të lidhura në kuptimin e këtij raportimi

Transaksionet e mëposhtme janë kryer me palët e lidhura.

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2022</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2021</u>
Huamarrje afatgjata nga ortakët	-	33,464,059
Totali	-	33,464,059
Detyrime ndaj furnitorëve	-	-
Totali	-	-
Kerkesa afatshkurtra ndaj administratorëve dhe ortakëve	5,935,791	-
Totali	5,935,791	-
Huadhenie afatgjata	34,314,840	26,072,540
Totali	34,314,840	26,072,540

22 MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe huatë afatgjata kontraktuale. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme dhe mjete monetare që sigurohen drejtpërdrejt nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit dhe të monedhës. Drejtimi i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit.

Shoqëria ka vetëm një hua afatgjatë, e cila është midis palëve të lidhura dhe për të nuk aplikohet interes. Gjithashtu shoqëria nuk ka filluar ende veprimtaritë normale dhe është në fazë të investimit. Si pasojë, në lidhje me riskun e tregut shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj riskut të luhatjes së kurseve të këmbimit, pasi ajo ndërmerr transaksione në monedhë të huaj dhe si pasojë ekspozohet ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Tabela më poshtë përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet financiare dhe përmbledh ekspozimin e shoqërisë ndaj riskut të kursit të këmbimit të monedhës së huaj në datën e raportimit.

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

23 ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

24 NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit, të cilat kërkojnë të bëhen rregullime apo të jepen informacione në këto pasqyra financiare.